REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
771/19
Datum: 09.12.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.771/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NNP "WENDA"-Vushtrri, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Astra Plan"sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes së re (projekt 3 vjeçar)" me nr. prokurimit: 644-19-5755-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri , më datë: 27.11.2019 , mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik NNP "WENDA"-Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes së re (projekt 3 vjeçar)" me nr. prokurimit: 644-19-5755-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri.

<u>II.VËRTETOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes së re (projekt 3 vjeçar)" me nr. prokurimit: 644-19-5755-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik NNP "WENDA"-Vushtrri, aprovohet si pjesërisht e bazuar të njëjtit operator ekonomik i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues: NNP "WENDA"-Vushtrri, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt:01.11.19, me nr. 771/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës,lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i çerdhes së re (projekt 3 vjeçar)" me nr. prokurimit: 644-19-5755-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- Kuvendi Komunal Vushtrri, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.11.2019, ka autorizuar eksperten profesionale të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja profesionale e prokurimit në raportin e dt 21.11.2019 sqaron si në vijim:
Përgjigje në Pretendimi nr.1 OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se K.K . Vushtrris nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së,
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është te sigurojnë mënyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimit qe do te përmbushen, OE. ankues pretendon duke përmend vetëm pjesën e nenit 1 për qëllimin e nenit dhe mënyrën e shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike pa i përmendur kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat qe do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimit qe do te përmbushen. Andaj edhe pretendimi i OE. ankues është i pa bazuar,

Sepse nuk mundë të shpallet fituesit një OE . pa u siguruar se i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara ne NJ. dhe DT. sepse nuk do të ishte në harmoni me nenin 1 te këtij ligji,
Andaj,Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuare .

Përgjigje në Pretendimi nr.2
OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se KK.- Vushtrris nuk ka respektuar nenin 6 të LPP-së, sipas OE. ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është te siguroj qe fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike ,duke e marr ne konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit Andaj trajtimi i OE. ankues i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së . (arsyet e eliminimit do sqarohen me poshtë konkretisht ne pretendimet 4 . dhe 5 lidhur me nenet 56 dhe 59 te LPP-Së.) Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.3
OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, sipas OE. ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve dhe trajtimi si OE. të eliminuar, Operatorin ekonomik ankues që nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe DT. është në harmoni me nenin 7 të LPP-së . Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.4
OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 56 të LPP-së, sipas OE. ankues .
Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret e parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe vlerësimi të bëhet konform ketij neni.
OE ankues,pretendon se AK-së ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së sepse na ka eliminuar për një kërkesë që nuk është parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, ndërsa neni 56.3 qartë e parasheh që "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, sipas OE ankues .

Ekspertja për të sqaruar fillimisht paraqet kriterin e paraparë me NJ.K. dhe D. T. i cili është pikë pretenduese :

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum në **vlerë 400,000.00 Euro.** Nëse OE tenderojnë në marrëveshje apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1 .Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet **ndërtimore** të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm; certifikatat ose referencat për kontratat e realizuara ku përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet;

OE ankues pretendon se AK-së nuk ka kërkuar referenca të ndërtimit të lart apo të ulët por ka cekur referenca të ngjashme andaj projektet tona të përfunduara brenda 3 viteve të fundit nga njoftimi për kontratë e plotësojnë kërkesën e AK-së

Ekspertja sqaron se pretendimi i OE. nuk është i saktë lidhur me kriterin e paraparë me NJ.K. dhe D. T. sepse OE . ankues nuk e ka përmendur fjalinë kryesore që e përcakton ngjajshmërin e kontratave e që është cekur te dëshmia e kërkuar dokumentare **„ aktivitete ndërtimore "** është esenciale kjo fjali sepse bazuare në ketë fjali e kemi të çart se cilat kontrata janë të ngjashme .

Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe **aktivitetet ndërtimore** të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare)

Ekspertja sqaron se OE. ankues ka dorëzuar listën e kontratave në platformën e e-prokurimit të nënshkruar dhe të vulosure ,mirëpo në atë listë ma tepër ka kontrata për Rrugë, Kanalizime ,Rrugë me kocka pastrim lumenjsh,i njëjti ka edhe disa kontrata për punë ndërtimore dhe të ngjashme mirëpo të njëjtat nuk e arrijnë minimumin e kriterit të paraparë me NJ.K.dhe me D.T.

(Gjatë ekzaminimit- kalkulimeve të vlerave të cilat gjinden në referenca ekspertja ka vërejtur që disa referenca të njëjta me numra të protokollit të njëjtë janë skenuarë dhe janë ngarkuar në platformën e e-prokurimit nga dy here nga OE .ankues ,ketë e potencoi për shkak të korrektësisë dhe me qellim që palët të informohen se një veprim i tillë është i pa pranueshëm sepse njëra referencë shihet mirë kurse referenca tjetër shihet me shumë vështirësi sepse skenimi është bërë në atë mënyrë dhe në këto raste Autoritetet

kontraktuese mund të bien në lajthim pa dashje e kjo nuk ka ndodhur në rastin konkret.) Andaj, Ekspertja Konstaton se pretendimi është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5

OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, sipas OE. ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit i cili OE. ankues e ka trajtuar si OE. të pa përgjegjshëm dhe trajtimi si OE i eliminuar Operatorin ekonomik ankues është në harmoni me nenin 59 të LPP-së .

Sa i përket pretendimit se OE. ankues ,lidhur mundësin e heqjes së dilemave për ndonjë kontratë përmes kërkesës për sqarime bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së i njëjti pretendim nuk qëndron sepse autoriteti kontraktues nuk ka pasur diçka të paqartë rreth kontratave sepse janë referencat e bashkangjitura që dëshmojnë për aktivitetet e OE. ankues ,e që shumica e atyre referencave ishin të lëshuara nga vet AK-së

Sa i përket pretendimit se AK-së e ka eliminuar padrejtësisht OE. ankues nuk qëndron,

Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.6

OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, sipas OE .ankues .

Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është të respektohen kriteret për dhënien e kontratës dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë :

Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Sa i përket pretendimit se OE.ankues i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. nuk qëndron dhe është i pa bazuare,

Andaj, Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.7 dhe Përgjigje në Pretendimin nr.8

OE ankues"NNP.Wenda"-Vushtrri pretendon se K.K .-Vushtrris nuk ka respektuar nenin 69dhe 72 të LPP-së, sipas OE.ankues .

Ekspertja sqaron se qellim i neni 69 është Aftësia teknike dhe profesionale e Ofertuesve dhe mundësia e sqarimeve përmes kërkesave nga AK-së përmes nenit 72 të këtij ligji.

OE sipërfaqësisht e përmendë nenin 69 lidhur me pretendimin se nuk është zbatuar neni 69 i këtij ligji nuk qëndron, Pretendimi i OE.ankues nuk qëndron sepse OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me NJ. K. dhe DT. (siq është sqaruar në përgjigjeje nr.4 dhe nr.5). Andaj, Ekspertja konstaton ky pretendim është i pa bazuar .

Mendimi i ekspertes profesionale: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit ekonomik ta HUDHË POSHT SI TË PA BAZUAR, (për arsyet që u cekën tek përgjigjeje në secilin pretendim) dhe i rekomandon panelit shqyrtues që vendimi i Autoritetit Kontraktues të mbetet në fuqi.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 22.10.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertes profesionale.

Autoriteti Kontraktues me datën 22.11.2019 përmes shkresës zyrtare është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertes profesionale, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 27.11.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues,përfaqësuesi i AK-së si dhe ekspertja profesionale, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së ankues z. Fetoshi deklaroj: Ne qëndrojmë ne tërësi pran pretendimeve tona ankimore te parashtruara ne ankesën tone dhe një herit ju njoftojmë se ne si OE ne këtë PA jemi eliminuar me arsyen se nuk kemi plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues e ku është kërkuar projekte te përfunduara te punëve te ngjashme ne 3 vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate minimum ne vlere 400.000.00. euro. Ju njoftojmë se si kërkesë apo dëshmi e kërkuar dokumentare ne lidhje n kërkesën e cituar me herët është kërkuar te jete lista qe duhet te specifikohen te gjitha projektet e punëve dhe aktiviteteve ndërtimore te realizuara ne periudhën 3 vjeçare, ndërsa ne lidhje me këtë kërkesë kemi ofruar listën e kontratave ku i siguron se ne kemi përfunduar pune mbi 2

MLN euro e qe faktikisht ne e plotësojmë kërkesën e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me kontratat e përfunduara ne periudhën 3 vjeçare.

Ne këtë aktivitet të prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka bërë një interpretim te gabuar për mendimin tone te kërkesës se tyre sepse aty qarte shkruan qe duhet te ofrohen dëshmi për pune te ngjashme dhe nuk ka qenë kërkesë recidive qe duhet te ofrohen dehmi për pune te ndërtimit te larte e ku si pune te ngjashme mund te hynë edhe punët e ndërtimit te ulet, asfaltimit, rrugët etj.

Duke pasur parasysh këtë fakt dhe këtë kërkesë rezulton se ne jemi eliminuar për një kërkesë qe nuk ka qenë ne DT dhe ne këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim te nenti 56.3 te LPP-së.

Po ashtu edhe sa i përket ekspertizës se eksperte ju njoftojmë se nuk pajtohemi me konstatimet e saj sepse ne një mënyrë është aprovuar blanko vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie te kontratës dhe ne lidhje me arsyen e eliminimit tone.

Po ashtu edhe ekspertes për mendimin tone nuk ka bërë interpretim te drejtë te kërkesës se Autoritetit Kontraktues ne lidhje me kontratat e kërkuara për pune te ngjashme për 3 vitet e fundit. Edhe ekspertja shqyrtuese nuk ka marr për bazë dhe nuk na ka llogaritur si valide kontratat e ngjashme qe kanë te bëjnë me ndërtim te ulet,rruge, asfaltime kanalizime e tj.

Sa për informime panelin shqyrtues ju sqarojmë se edhe ne këtë Ap ne paramasë janë te parashikuara pepeq punëve ndërtimore edhe pune te instalimit te ujësjellësit dhe kanalizimit, pune te instalimit te elektrikes, instalimi i ngrohjes qendrore e etj. E qe ne këtë rast nënkuptohet ne këtë AP nuk ka te bëjë vetëm me ndërtimin e vrazhdë dhe ndërtim te larte. Prandaj ne konsiderojmë se jemi eliminuar pa te drejt ne këtë AP.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Islami deklaroj: Ne këtë AP kemi paraparë ndërtimin e Objektit qe është ndërtim i larte dhe kërkesat e vendosura janë drejt se kemi thënë pune te ngjashme duke pasur parasysh renovimet e objekteve mund te konsiderohen te ngjashme është marr edhe vendimi për eliminimin e OE. Listën ofruar shumica e kontratës ka ndërtimin e rruge, ka pas edhe projekte te punëve te ngjashme mirëpo nuk e kanë përmbushur vlerën e paraparë te kërkesës. Prandaj ne si Autoriteti Kontraktues pajtohemi ne tërësi me mendimin e E.Sh.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja profesionale znj. Krasniqi deklaroj: Pas shqyrtimit te Pretendimeve te OE ankues edhe ekzaminimin e dokumenteve te dorëzuara nga OE ankues kam ardhur ne përfundim se vendimi i Autoritetit Kontraktues qëndron dhe i njëjti është i bazuar ne lpp. OE ankues ne platfort te e-prokurimit ka ofruar me tepër se 20 referenca mirëpo nuk janë te natyrës se ngjashme dhe unë ne cilësinë e ekspertes konsideroj se pretendimet e OE ankues janë te pa bazuara.

Referuesi i Panelit shqyrtues Pyeti përfaqësuesin e OE ankues: Ju thate se keni referenca ne vlere mbi 2 MLN euro a mund ta precizoni cilat janë?

Përfaqësuesi i OE ankuese z. Fetoshi u përgjigj: Ndërtimi larte qe ka thënë Autoriteti Kontraktues kanë vlere 170.000.00 euro, ne kontrata te ngjashme konsiderojmë se kemi mbi 2 MLN euro, si sqarim ne jemi edhe ofertues me i lire ne krahasim me OE-ne e rekomanduar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankues z.Fetoshi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues qe te aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe ky AP te kthehet ne rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit te detyrohet Autoriteti Kontraktues ti respektoj kërkesat dhe kriteret e vendosura ne FDT

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Islami deklaroj: : I propozojmë panelit shqyrtues qe ta hedh si te pa bazuar ankesën e OE dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se qëllimi i këtij neni është që autoritetet kontraktuese të sigurojnë mënyrë ma efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet, rregullat që do të zbatohen procedurat të cilat do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen. Operatori ekonomik ankues pretendon duke përmend vetëm pjesën e nenit 1 për qëllimin e nenit dhe mënyrën e shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike pa i përmendur kushtet apo rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen. Andaj, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar sepse nuk mund të shpallet fitues një OE pa u siguruar se i ka plotësuar te gjitha kriteret e parapara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit sepse nuk do të ishte në harmoni me nenin 1 te këtij ligji. Andaj, ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues se nuk ka respektuar nenin 6 të LPP-së, Paneli Shqyrtues sqaron se qëllimi i këtij neni është që të siguroj që fondet

publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike, duke e marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Andaj, trajtimi i OE ankues i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së. Pra, ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues se nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, Paneli Shqyrtues sqaron se qëllimi i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertuesve. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se autoriteti kontraktues nuk e ka diskriminuar OE ankues, përkundrazi e ka trajtuar në mënyrë të barabart konform nenit 7 të LPP-së. Pra, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues se nuk ka respektuar nenin 56 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale të prokurimit sqaron se qellimi i këtij neni është të respektohen kriteret e parapara me Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, si dhe vlerësimi të bëhet konform këtij neni. OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së duke aluduar se AK e ka eliminuar për një kërkesë që nuk është parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë, ndërsa neni 56.3 qartë e parasheh që "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale vlerëson se kriteri i paraparë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit ka qenë: *III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.* Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum në **vlerë 400,000.00 Euro.** Nëse OE tenderojnë në marrëveshje apo konsorcium, atëherë lideri i grupit duhet t'i ketë 60% të vlerës së kërkuar; Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1 .Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet **ndërtimore** të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm; certifikatat ose referencat për kontratat e realizuara ku përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet. Lidhur me këto kërkesa, OE ankues pretendon se AK-së nuk ka kërkuar referenca të ndërtimit të lartë apo të ulët por ka cekur referenca të ngjashme andaj projektet tona të përfunduara brenda 3 viteve të fundit nga njoftimi për kontratë e plotësojnë kërkesën e AK-së.
Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale sqaron se pretendimi i OE nuk është i saktë lidhur me kriterin e paraparë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit sepse OE ankues nuk e ka

përmendur fjalinë kryesore që e përcakton ngjajshmërinë e kontratave e që është cekur te dëshmia e kërkuar dokumentare **"aktivitete ndërtimore"**, është esenciale kjo fjali sepse bazuar në ketë fjali e kemi të çart se cilat kontrata janë të ngjashme. Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe **aktivitetet ndërtimore** të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare. Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale sqaron se OE ankues ka dorëzuar listën e kontratave në platformën e e-prokurimit të nënshkruar dhe të vulosur, mirëpo në atë listë më tepër ka kontrata për Rrugë, Kanalizime, Rrugë me kocka, pastrim lumenjësh, i njëjti ka edhe disa kontrata për punë ndërtimore dhe të ngjashme mirëpo të njëjtat nuk e arrijnë minimumin e kriterit të paraparë në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Paneli Shqyrtues është njoftuar nga ekspertja profesionale e cila me rastin e trajtimit të kësaj lënde, në ekspertizën e saj e ka cekur që OE ankues ka futur disa referenca të njëjta në plotformën e e-prokurimit, ku referencat e njëjta me numër të njëtë të protokollit ishin skanuar në atë mënyrë që njëra kishte pamje të lexueshme kurse tjetra nuk mund të lexohej, edhe pse bëhej fjalë për referenca të njëjta. Pra, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale sqaron se qëllimi i këtij neni është "Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve". Në këtë kuptim, autoriteti kontraktues fillimisht ka themeluar komisionin e vlerësimit, ky komision e ka vlerësuar ofertën e OE ankues si të papërgjegjshëm në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me mundësin e heqjes së dilemave për ndonjë kontratë përmes kërkesës për sqarime bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, ky pretendim ankimor nuk qëndron sepse autoriteti kontraktues nuk ka pasur diçka të paqartë rreth kontratave, pasi që referencat e bashkangjitura dëshmojnë për aktivitetet apo punët e kryera nga OE ankues, ku shumica e atyre referencave ishin të lëshuara nga vet AK-ja. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 60 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale sqaron se qëllimi i këtij neni është të respektohen kriteret për dhënien e kontratës dhe kriter për dhënien e kontratës ka qenë: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Pra, sa i përket pretendimit se OE ankues i ka plotësuar kriteret e parapara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "WENDA"-Vushtrri se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 69 dhe 72 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertes profesionale sqaron se qëllimi i nenit 69 është Aftësia teknike dhe profesionale e Ofertuesve dhe mundësia e sqarimeve përmes kërkesave nga AK-

së përmes nenit 72 të këtij ligji. OE. sipërfaqësisht e përmendë nenin 69 lidhur me pretendimin se nuk është zbatuar neni 69 i këtij ligji nuk qëndron. Pretendimi i OE ankues nuk qëndron sepse OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret e parapara në Njoftimin për Kontrarë dhe në Dosjen e Tenderit, sic është sqaruar edhe në përgjigjet e pretendimeve të cekura si më lartë. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertes profesionale vlerëson se Autoriteti Kontraktues KK Vushtrri, gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e LPP-së, për faktin se ka rekomanduar për dhënie të kontratës operatorin ekonomik, i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROCEDURËS TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE PRISHTINË REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Bledim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Kuvendi Komunal Vushtrri

1x1 OE - NNP "WENDA"-Vushtrri

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim nëueb- faqe të OSHP-së.